REPUBLIKA E SHQIPERISË
BASHKIA SARANDË
KËSHILLI BASHKIAK

Nr_____ Prot Sarandë, më / /

PROJEKT-VENDIM

Nr.141,datë27. 11 .2025

PËR MIRATIMIN E PLANIT TË AKTIVITETEVE TË KËSHILLIT TË BASHKISË SARANDË PËR PERIUDHËN JANAR - DHJETOR 2026

Këshilli i Bashkisë Sarandë në zbatim të Ligjit Nr.139/2015"Për Vetëqeverisjen Vendore" neni 54 dhe në zbatim të Rregullores së Funksionimit dhe Organizmit të Këshillit Bashkiak, Kreu VIII."Financimi i Aktiviteteve të Këshillit", Neni 101 "Programi i Punës së Këshillit Bashkiak",me propozim të Kryesisë dhe Kryetarit të Këshillit, Këshillit Bashkiak,

VENDOSI

1. Miratimin e planit të aktiviteteve të veprimtarisë së Këshillit të Bashkisë Sarandë për periudhën Janar - Dhjetor 2026, bashkëngjitur këtij vendimi.

2. Cdo Komision, anëtar i këshillit,gjatë vitit kalendarik mund të propozoj tematika të çështjeve të ndryshme të cilat ata mendojnë se ndikojnë në përmirësimin e treguesve të performancës së punës së administratës,të Këshillit dhe në shërbim të komunitetit.

3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Këshilli i Bashkisë dhe Kryetari Bashkisë.

4. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar.

KRYETAR

ASAF STROKA